



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

# RAPORT VJETOR 2022

PËR

**GJENDJEN, SHFRYTËZIMIN, MONITORIMIN,  
MIRËMBAJTJEN DHE SIGURINË E DIGAVE TË  
MËDHA DHE DAMBAVE NË SHQIPËRI.**

Tiranë, Mars 2023



## PËRMBAJTJA

- 1. Të përgjithshme**
- 2. Qëllimi i hartimit të Raportit Vjetor**
- 3. Baza ligjore**
- 4. Gjendja aktuale e digave të mëdha dhe dambave**
- 5. Mirëmbajtja, monitorimi dhe siguria e digave dhe dambave**
- 6. Programi dhe aktivitetet e KKDM gjatë vitit 2022**
- 7. Përfundime për situatën në sektorin e digave të mëdha**
- 8. Rekomandime për përmiresimin e situatës në të ardhmen**

### Shtojcat:

- Shtojca 1 - Lista e digave të mëdha dhe shfrytëzuesit e tyre në Shqipëri, 2022.
- Shtojca 2 - Statistikat kryesore për digat e mëdha në Shqipëri, 2022.
- Shtojca 3 - Programi i punës së KKDM për vitin 2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## 1. Të Përgjithshme

Shqipëria është një vend me relief malor dhe kodrinor dhe është një vend shumë i pasur me ujë. Ky relief dhe kjo pasuri e madhe ujore, krijon kushte shumë të favorshme për ndërtimin e rezervuarëve artificialë të ujit, i cili ka rëndësi të madhe jetike. Kjo bën që këto rezervuarë, digat që i formojnë ata, për vetë qëllimin e formimit të tyre (vadtje, prodhim energjie, akuakulturë, turizëm, etj.), të kenë gjithashtu nevojën edhe të monitorimit të tyre për arsye sigurie, por dhe kujdes të veçantë për administrimin dhe përdorimin me sukses të këtyre pasurive të burimeve ujore natyrore.

Vendi ynë është i ndarë në 7 basene kryesore lumore ku rrjedhin ujrata e 39 lumenjve kryesore. Ata shkarkojnë mesatarisht afro 1250 m<sup>3</sup>/s (40 miliard m<sup>3</sup> ujë në vit) në Detin Adriatik dhe detin Jon.

Territori hidrografik i Shqipërisë ka një sipërfaqe prej 44 000 km<sup>2</sup> ose 57 % më shumë se territori shtetëror i vendit. Në territorin hidrografik të saj bien afro 1400 mm shi në vit dhe në lartësitë 1000 m mbi nivelin e detit bien rreshje dëbore. Rreth 70 % e prurjes vjetore të lumenjve tanë derdhet në periudhën ujëshumë Nëntor - Prill dhe 30 % derdhet në periudhën ujëpakët Maj - Tetor. 35 % e prurjeve mesatare të ujit të këtyre lumenjve përdoren për prodhim energjie ujore dhe afro 1 miliard m<sup>3</sup> ujë përdoren për ujitje të afro 360 000 ha toka bujqësore.

Një rol shumë të rëndësishëm në administrimin e këtyre ujrave luajnë digat e mëdha të ndërtuara në disa lumenj të vendit të cilat përdoren për prodhimin e energjisë ujore, furnizimit me ujë të pijshëm, ujitjet e tokave bujqësore, mbrojtjen nga përmbytjet, rritjen e peshkut, transportin ujqor, turizem dhe zhvillimin urban. Deri më sot, në Shqipëri janë ndërtuar afro 652 diga të mëdha dhe të vogla.

Sipas Rregjistrimit Kombëtar të Digave të Mëdha të hartuar dhe aprovuar nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në vendin tonë aktualisht janë **351 diga të mëdha** të përcaktuara sipas Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i përditësuar në datë 14.02.2003.

Sipas Rregjistrimit të Komisionit Ndërkombëtar të digave të mëdha (ICOLD), Shqipëria është në vendin e 19 në botë për numrin e përgjithshëm të digave të mëdha dhe renditet në vendin e parë në Europë për numrin e digave të mëdha për km<sup>2</sup> si dhe për numrin e digave të mëdha për 1 milion banorë.

24 diga të mëdha përdoren për prodhim energjie ujore, 320 diga të mëdha përdoren për ujitje (rezervuarët e 130 prej tyre përdoren edhe për peshkim), 5 diga të mëdha për atraksione urbane dhe aktivitete turistike dhe 2 diga të mëdha janë ndërtuar për furnizim me ujë të pijshëm.

Në Shqipëri aktualisht janë dhjetë diga shumë të mëdha me lartësi mbi 60 m dhe tre Kaskada kryesore të ndërtuara në lumenjtë Drin, Devoll dhe Mat të cilat përdoren kryesisht për prodhim hidroenergjie si dhe për peshkim, ujitje, mbrojtje nga përmbytjet dhe vende turistike natyrore.

Njëkohësisht, ato janë digat me rrezikun më të lartë për dëmtime në ekonomi dhe humbje në njerëz në rastet e ndonjë ngjarje natyrore katastrofike apo prishje të mundshme të ndonjë dige.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Të gjitha **digat e mëdha janë vepra të rëndësishë së vecantë dhe kërkojnë marrjen e tërësisë së masave organizative, teknike dhe financiare** që të garantojnë shfrytëzimin normal të tyre, jetëgjatësinë më të madhe dhe mosçënimin e të tretëve gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Aktualisht, Digat e mëdha administrohen dhe përdoren nga 67 operatorë të ndryshëm ku:

- 54 operatorë janë Bashkitë e vendit që administrojnë 320 diga të mëdha,
- 1 operator është operator publik shtetëror (KESH sh.a.) i cili administron 6 digat e kaskadës së lumit Drin,
- 1 operator është operator publik shtetëror (MBZHR) i cili administron 8 digat e mëdha për ujitje,
- 1 operator është operator privat (KURUM sh.p.k.), i cili përdor 3 diga të mëdha në lumenjtë Mat dhe Bistricë.
- 8 operatorë janë privat që i kanë marrë me konçesion për prodhim energjie ujore, (Devolli HP, AYEN, Inerte Lumzi, Favina, Diteco, Teodori 2003, Hydroenergy....),
- 2 operatorë janë ndërmarrjet e Ujësjellës - Kanalizimeve (UK Durrës dhe UK Tiranë).

Gjithashtu, në KKDM janë të regjistruar edhe 3 damba të mëdha që përdoren nga kompani private të nxjerrjes së kromit.

## 2. Qëllimi i hartimit të Raportit vjetor

**Qëllimi kryesor i përgatitjes së këtij raporti vjetor, është për të informuar Këshillin e Ministrave për gjendjen e digave të mëdha dhe dambave, problematikat në sektorin e digave dhe dambave duke përfshirë jo vetëm mungesën e kontrollit dhe monitorimit të tyre në pjesën më të madhe të digave, por edhe domosdoshmërinë për një reformë të thellë e të plotë institucionale dhe ligjore në institucionet përgjegjëse për shfrytëzimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen dhe sigurinë e tyre si dhe për të dhënë konkluzionet dhe sugjerimet përkatëse për ecurinë normale dhe përmirësimet e nevojshme në këtë sektor të rëndësishëm për ekonominë e vendit.**

Njëkohësisht, përmes këtij Raporti, KKDM kërkon të bëjë sensibilizimin e Institucioneve përkatëse kryesore dhe shfrytëzuesit e digave të mëdha për rëndësinë e sigurisë dhe monitorimit të digave, vlerat e mëdha ekonomike që kanë në përdorim si dhe për pasojat e rënda që mund të ketë nga mungesa e mirëmbajtjes, kontrollit dhe monitorimit të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

### 3. Baza Ligjore

Për përgatitjen e Raportit Vjetor të vitit 2022 për Gjëndjen, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Digave dhe Dambave në Shqipëri, KKDM është bazuar në legjislacionin në fuqi si më poshtë:

#### Aktet Ligjore

- Ligji Nr. 8681, dt. 02.11.2000 “Për Projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i përditësuar në dt.14.02.2013.
- Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 111/2012, date 15.11.2012 “Mbi Menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore” i përditësuar me ligjin Nr.6/2018,
- Ligji Nr. 242, date 09.03.2017 “Per Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”,
- Ligji Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”

#### Vendimet e Këshillit të Ministrave

- VKM Nr. 147, dt. 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”,
- VKM Nr. 4, dt. 18.07.2003 “Për kërkesat e dokumentacionit teknik dhe ligjor që duhet të përmbajnë dosjet teknike/ pasaportat e digave”,
- VKM Nr. 1108, dt. 30.12.2015 “Për transferimin e sistemeve dhe digave të ujitjes tek pushteti lokal”,

#### Udhëzime dhe rekomandime të KKDM dhe të ICOLD

- Udhëzimet e KKDM për;
  - Hartimin e rregulloreve të shfrytëzimit të digave dhe dambave,
  - Monitorimin e digave të mëdha pas termetit,
  - Përgatitjen e pasaportave të digave dhe dambave,
  - Përgatitjen e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga prishja e mundëshme e digave.
- Buletinet e ICOLD për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe sigurinë e digave të mëdha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

#### 4. Gjendja aktuale e digave të mëdha dhe dambave

Bazuar në Raportet Vjetore të ardhura nga 20 Shfrytëzues të digave (vetem 30 % e numrit total të tyre), si dhe nga inspektimet dhe kontrollat e kryera gjatë vitit 2022 nga KKDM, dëshirojmë t'ju informojmë se në përgjithësi **digat e mëdha nuk monitorohen dhe nuk mirëmbahen nga shfrytëzuesit e digave sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi duke sjellë përkeqësim të gjendjes së tyre, mungesë të njohjes së situatave aktuale dhe krijimin e problemeve të panjohura për zonat urbane poshtë tyre. Kjo situatë është më problematike në digat që përdoren dhe janë në pronësi të bashkive të vendit të cilat kanë treguar gjatë këtij viti një neglizhencë në mirembajtjen dhe monitorimin e tyre. Në keto bashki vërehen edhe probleme që lidhen me mungesën e inxhinierëve dhe njësive të kontrollit teknik të tyre.**

**Fakti që mëse 75 % e bashkive nuk dorëzojnë raportin vjetor për gjendjen e digave, tregon më së miri neglizhencën dhe pafhtësinë e tyre për administrimin, kontrollin dhe monitorimin e digave. Ndër bashkitë që nuk kanë sjellë raporte vjetore për gjendjen e digave, mund të përmendim Bashkinë e Tiranës ku janë afro 38 diga të mëdha, bashkia Devoll ku janë mëse 10 diga të mëdha, Bashkitë e qarkut të Gjirokastrës ku janë afro 47 diga të mëdha, bashkitë e qarkut të Beratit ku janë afro 33 diga të mëdha si dhe bashkitë e qarkut Vlorë dhe Elbasan me më shumë se 40 diga të mëdha. Në këto bashki sipas inspektimeve të kryera nga KKDM, mungojnë stafi teknik me inxhinierë të digave dhe ekipet e sigurisë së tyre, si dhe ka shumë diga që nuk përdoren dhe janë jasht funksionit për probleme teknike të vogla si dhe për neglizhencë të përdoruesve të tyre. Njëkohësisht, duhet të theksojmë se edhe shumica e raporteve vjetore të ardhura pranë KKDM, tregojnë një mungesë dhe problematikë të theksuar në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të tyre si dhe mungesë të dokumentacionit teknik të domosdoshëm. Në asnjë prej bashkive që përdorin digat e mëdha, nuk janë bërë trajnime të stafit teknik të tyre që prej marrjes në pronësi të këtyre digave nga MBZHR. Në shumicë e bashkive mungon dokumentacioni teknik për digat (projekti i detajuar, të dhënat e monitorimit ndër vite, etj), i cili nuk është dorëzuar nga MBZHR në periudhën e transferimit të aseteve të digave sipas kërkesave të VKM Nr. 1108, date 30.12.2015.**

Theksojme se në këto proces ka munguar një vlerësim i aseteve të këtyre digave si dhe kontrolli dhe drejtimi i duhur i procesit nga prefekturat.

Theksojme se më se 50 % e digave të mëdha kanë si problem shqetësues vjetërsinë e tyre. Me se 110 diga të mëdha që përdoren për ujitje të cilat janë me material vendi, janë ndërtuar para 50 viteve në një kohë që projektimi i tyre sipas standarteve teknike të kohës për këto lloj digash kanë qenë të projektuar për jo më shumë se 50 vjet. Kjo situatë kërkon rivlerësimin sa më të shpejtë të jetë e mundur e kushteve aktuale të këtyre digave sipas standarteve bashkëkohore, sidomos digat e mëdha në qarkun e Durrësit dhe Tiranës në lidhje me masat e monitorimit sizmik, prurjeve maksimale dhe procesin e sedimentimit tek rezervuarët e krijuar prej tyre. Theksojmë se këto diga nuk kanë të dhëna të monitorimit të tyre për arsye se shfrytëzuesit e tyre (bashkitë) nuk kanë instaluar asnjë instrument për monitorimin e këtyre digave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Njëkohësisht, **Sipas MBZHR, afro 70 diga të mëdha, nuk përdoren**, për arsye se kanë dalë jasht funksionit. Gjithashtu, disa bashki që janë shfrytëzuese të këtyre digave si bashkia Korçë, Roskovec dhe Memaliaj, kanë kërkuar nxjerrjen jasht funksionit të disa digave të mëdha të administruara prej tyre por pa paraqitur ndonjë projekt apo plan braktisje apo miratim nga Ministria përkatëse. KKDM sugjeron dhe kërkon rivlerësim teknik nga specialistë me eksperiencë në këtë fushë dhe të liçencuar të cilët të hartojnë projektin dhe raportin e duhur në përputhje me standartet teknike shqiptare, rekomandimet e ICOLD dhe legjislacionin në fuqi.

Nëse në bazë të këtij rivlerësimi do të plotësohet një prej kërkesave të dhëna në VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, Kreu V, neni 38, KKDM do të kërkojë menjëherë për shqyrtim nga shfrytëzuesi i digës projektin dhe planin e braktisjes të miratuar nga Ministria e linjës ose institucionin që e administron. Ky projekt duhet të shqyrtohet dhe të miratohet në KKDM për ti hapur rrugë dekomisionimit të tij.

**Gjatë vitit 2022 duke u bazuar në komunikimin me shfrytëzuesit e digave dhe disa inspektimeve në terren, na rezulton se në mëse 90 % të digave të mëdha të vendit, ka mungesë të mirëmbajtjes së vazhdueshme nga shfrytëzuesit e digave, mungesë të sistemeve të monitorimit dhe kontrollit të tyre përmes instrumentave sic kërkohej në nenin 32 të VKM përkatëse, mungesë të rregulloreve të shfrytëzimit të digave sipas kërkesave të nenit 29 të këtij Vendimi, mungesë të matjeve të volumeve aktuale të ujit dhe të sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga sipas kërkesave të nenit 30 të VKM përkatëse si dhe mungesë të Planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe të hartave të përmbajtjeve duke mos respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. Megjithëse nga buxheti i shtetit, gjatë vitit 2022 janë dhënë mjaft fonde në këtë drejtim përmes Agjencise së Mbrojtjes civile pranë Ministrise së Mbrojtjes, rezulton se këto fonde janë përdorur në masën jo më shumë se 50 % nga bashkitë për zgjidhjen e problematikave në lidhje me monitorimin dhe sigurinë e digave, hartimin e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile apo matjet në lidhje me volumet e ujit në rezervuar dhe procesin e sedimentimit në to.**

**Në mëse 95 % të digave të mëdha mungojnë sistemet e alarmit në përputhje me standartet bashkëkohore dhe kërkesat e KKDM.** Kjo problematike është më e theksuar në digat që përdoren për ujitje dhe që administrohen nga MBZHR dhe nga bashkitë e vendit.

Deri më sot nuk ka patur informacione nga shfrytëzuesit e digave në lidhje me ndonjë dëmtim serioz apo prishje totale të digave prej dheu. Bazuar në informacionin e marrë nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar i cili ka kryer inspektime në terren dhe analiza të detajuar, rezulton se ka patur disa dëmtime të shfaqura gjatë vitit 2022 e më parë siç janë dy digat në bashkinë Tropojë, Diga e Vasjarit në Memaliaj, Diga e Pacomit në Përmet, diga e Kurjanit në Roskovec, diga e Rubjekës në Shijak, diga e Harvales në Selenicë, diga e Zallherrit, Çekrezës dhe Farkës në Tiranë, Diga e Manskurisë në Kavajë, etj. Në këto diga por edhe në diga të tjera që nuk janë inspektuar nga SHGJSH, ka shenja të qarta për vazhdim të mundshëm të dëmtimeve dhe rrezikut të rrëshqitjeve të dherave në anën e poshtme të digave të mëdha,

KKDM deshiron të theksojë se në rast se nuk merren masat e duhura për rehabilitimin e tyre në kohën e duhur, do të ketë përkeqësime të situatave dhe prishje të mundshme të këtyre digave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM verën se shfrytëzuesit e digave I ngrejne shqetësimet për gjendjen e digave vetëm në periudhën e rreshjeve të mëdha nga frika e problemeve të grumbulluara ndër vite.

Rehabilitimet e kërkuara nga shfrytëzuesit e digave gjatë vitit 2022, vetëm në momentin e shfaqjes në përmasa të pariparueshme për rreshqitjet që ndodhin gjatë sezonit ujëshumë apo rehabilitimet e shkarkuesve në këto periudha, nuk i shërbejnë sigurisë së digës por janë vetëm zgjidhje emergjente për të shmangur pasojat e rrezikshme që lidhen me sigurinë e tyre dhe me sigurinë e banorëve që ndodhen poshtë tyre. Theksojmë se shfrytëzuesit e digave duhet të mendojnë për rehabilitime të tilla në periudhat e verës dhe të vjeshtës si dhe një monitorim të vazhdueshëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KKDM ka vërejtur se **procesi i transferimit të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të digave të digave të ujitjes** si pjesë përbërëse e infrastrukturës së ujitjes i kryer në bazë të VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 që prej 8 vitesh **nuk ka sjellë asnjë përmirësim në përdorimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e tyre.**

**Ky proces në 90 % të rasteve është kryer në mungesë të një dokumentacioni teknik tek shfrytëzuesit e digave nga MBZHR, pa dorëzuar dosjen teknike të digave, pasaportat e tyre, pa kryerjen e një procesi të rregullt të vlerësimit dhe rregjistrimit të aseteve të digave dhe elementeve të saj, pa trajnime për ekipin e Inxhinierëve të digave, pa dorëzim të sistemeve të monitorimit të digave si dhe të pashoqëruara me harta të përmytjeve dhe plane të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile.** Këto kërkesa ishin detyrime ligjore për të cilat MBZHR dhe prefekturat përkatëse duhet ti kryenin për të plotësuar një proces korrekt, profesional dhe ligjzbatues. Kjo situatë nuk justifikon mungesën e masave nga pushtetet lokale për përgatitjen e këtyre dokumentave të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Aktualisht ndodhemi përpara faktit që asetet e digave të mëdha nuk janë të vlerësuara dhe të rregjistruara në Agjencinë Kombëtare të Kadastrës dhe bashkitë nuk kanë asnjë të dhënë në lidhje me vlerën e këtyre aseteve. Megjithatë kërkesat e here pas herëshme të KKDM, **deri më sot, për mëse 99 % të digave të mëdha, nuk ka një vlerësim dhe regjistrim të aseteve të digave të mëdha.**

Aktualisht, sipas informacioneve të ardhura pranë SKDM, vetëm 50 dosje teknike të projektit origjinal për digat e mëdha që përdoren për ujitje, ndodhen në Arshiven e MBZHR. Cilësia e këtyre projekteve është mjaft e dobët dhe kërkohet një proces teknik profesional për përgatitjen e dokumentacionit teknik përkatës sipas standarteve teknike. Për transferimin e dokumentacionit teknik të plotësuar si dhe përditësimin me projektet e rehabilitimit të kryer për disa diga, mendojmë se duhet të kryhet një proces i rregullt dhe profesional me pjesëmarrjen e përbashkët të shfrytëzuesve të digave, MBZHR dhe Institutin e Ndërtimit si dhe prefekturave përkatëse. Ky proces duhet të drejtohet nga KKDM dhe të shoqërohet edhe me një proces trajnimi të ekipit teknik që është përgjegjës për monitorimin dhe sigurinë e tyre.

Bazuar në raportin vjetor të MBZHR, jemi informuar se kjo Ministri është në komunikim që prej 3 vitesh me ekspertë të Bankës Botërore për të inspektuar dhe kontrolluar gjendjen e mëse 420 digave në vendin tonë duke përjashtuar afro 195 diga që janë kontrolluar në vitet 2009-2010, ku 14 prej të cilave janë rehabilituar me financime të Bankës Botërore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM shpreh mendimin e saj se procesi i kontrollit të digave të mëdha duhet të kryhet në bazë të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, duke u bazuar në një program pune të përcaktuar mirë sipas prioriteteve dhe rëndësisë së digave si dhe duke u mbështetur në kapacitetet teknike të vendit dhe financimet e buxhetit të shtetit.

Sipas legjislacionit të mësipërm, ky kontroll duhet të kryhet të paktën çdo 10 vjet nga shfrytëzuesit e digave. Për zgjidhjen emergjente të kësaj problematike, **KKDM sugjeron se shfrytëzuesit e digave mund të kryejnë këto kontrolle përmes kontratave përkatëse me Institutin e Ndërtimit, institucione të tjera teknike, apo dhe kompani të licensuara në këto fusha**, duke u bazuar në tarifa shtetërore të përcaktuara me vendime zyrtare sipas kontributit të specialistëve përkatës gjeolog/sizmolog/hidroteknik/gjeodet/mjedis/konstruktor dhe madhësisë së objektit.

Kjo mënyre jo vetëm që do të kursejë fonde nga financimi i Bankës Botërore, por do të krijojë mundësinë e angazhimit të specialistëve shqiptarë në këtë sektor, mundësinë e trajnimit për inxhinierët lokalë dhe krijimin e një baze të dhënash sa më të plotë.

Rezultatet dhe rekomandimet e këtyre kontrolleve sidomos në drejtim të monitorimit dhe sigurisë së digave, duhet të zbatohen nga shfrytëzuesit e digave brenda vitit pasardhës.

Gjithashtu, në realitetin e shfrytëzimit të digave nga kompanitë e prodhimit të energjisë ujore përmes HEC-eve, të cilët janë shfrytëzues të digave të mëdha, ka shumë raste të mos respektimit të kërkesave të legjislacionit të sipërcituar (Ligji Nr.8681, Datë 02.11.2000).

Mjafton të përmendim faktin se 40 % e shfrytëzuesve të digave të mëdha nuk kanë sjellë ende raportet vjetore për gjendjen e digave në vitin 2022, apo nuk kanë dorëzuar dhe aprovuar rregulloret e shfrytëzimit dhe monitorimit të digave në KKDM. Këto ndodhin edhe me institucionet shtetërore të rëndësishme. Raste tipike mund të përmenden mosplotësimi i kërkesave të ligjit në lidhje me aprovimin e mbikqyrjes së punimeve nga KKDM apo kolaudimin e punimeve të kryera, mosdorëzimi i projekteve teknike sipas faktit për punimet e kryera për rehabilitimin e digave dhe elementeve kryesore të tyre si shkarkuesit, veprat e marrjes, etj.

Gjatë vitit 2022 janë kryer disa punimeve rehabilitimi në disa diga të mëdha siç është diga e Çekrezës dhe diga e Pezë Gjyslikanes në Tiranë, diga e Paskuqanit në Kamëz dhe diga e Spitallës në Durrës. Për të gjitha këto punime për rehabilitimin e digave, shfrytëzuesit e tyre nuk kanë informuar në lidhje me mbikqyrjen e punimeve apo kolaudimin e këtyre punimeve siç kërkohet në legjislacionin përkatës për sigurinë e digave. Theksojmë se në bazë të ligjit për këto punime kërkohet miratim nga KKDM për Mbikqyrësin e punimeve të zgjedhur nga Shfrytëzuesi si dhe përfaqësues të Inspektoriatit Teknik të Digave (ITD) gjatë kryerjes së punimeve. **Mungesa e Inspektoriatit Teknik të Digave, i cili ende nuk është krijuar nga MIE, si strukturë e posaçme brenda SKDM, ka krijuar probleme** jo vetëm për kontrollin e gjendjes së digave apo punimeve të kryera në to, por edhe për marrjen e masave dhe penaliteteve të kërkuara nga ligji në fuqi gjatë kontrollit të punimeve në terren si dhe kontrollit të dokumentacionit të kërkuar që duhet të jetë pranë shfrytëzuesit të digave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Për rrjedhojë, **KKDM do të kërkonte një zgjidhje të shpejtë dhe një riorganizim të SKDM dhe ITD** e cila do të përmiresojë ndjeshëm kontrollin me cilësi të këtyre veprave që janë të një rëndësie të veçantë. Për të zgjidhur problematikën emergjente të kontrollit të digave, do të sugjeronim **krijimin e ITD dhe të ekipeve të kontrollit të digave pranë Institutit të Ndërtimit, i cili është strukturë e MIE** dhe ka kapacitete teknike dhe hapësira ligjore për të kryer këtë shërbim të domosdoshëm.

Në të ardhmen, mendojmë se duhet të kryhet një reformë e thellë institucionale, organizative dhe ligjore në sektorin e digave. Mjafton të përmendim përvojën e vendeve të Europës të cilat për një kontroll të shtetit më të plotë, më efikas dhe të specializuar, kanë krijuar **Autoritetet e Sigurisë së digave** ku punojnë specialistë hidroteknike, kosntruktor, gjeolog, sizmolog, gjeodet, mjedis dhe kanë krijuar bazën e të dhënave të monitorimit të këtyre digave të cilat raportohen sipas ligjit çdo 6 muaj në këto Autoritete. Ky autoritet mund të jetë i atashuar pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjitikes ose Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve ujore (AMBU) ose Ministrisë së Mjedisit ose të krijohet si një agjenci e specializuar e pavarur e Këshillit të Ministrave siç është Enti rregullator i Ujit. Kjo reformë është mjaft e rëndësishme për vetë faktin se ky sektor i lënë në harresë është me rëndësi të veçante për ekonominë e vendit.

Në lidhje me gjendjen aktuale të dambave theksojmë se shfrytëzuesit e tyre dhe AKBN nuk kanë dhënë asnjë informacion në lidhje me gjendjen e tyre megjithë kërkesat e përsëritura nga KKDM në drejtim të MIE, AKBN dhe fabrikave të pasurimit të kromit dhe bakrit ku janë këto damba. Deri më sot, vetëm 3 kompani kanë dhënë një dokumentacion teknik për dambat që përdorin por asnjë prej tyre nuk ka dhënë raportin vjetor për gjendjen e tyre.

Sipas informacione të mbledhura gjatë kontrolleve në terren, nuk janë vëne re probleme teknike të mëdha por është vënë re se nuk ka një inventar të plotë të dosjeve teknike të tyre, kapaciteteve që kanë, rregulloreve të shfrytëzimit të tyre apo skemave teknologjike të shfrytëzimit.

## **5. Mirëmbajtja, Monitorimi dhe Siguria e digave dhe dambave nga Shfrytëzuesit**

Mirëmbajtja dhe monitorimi i digave të mëdha janë dy elemente kryesorë që jo vetëm rrisin sigurinë e digës, por shtojnë edhe jetëgjatësinë e saj. KKDM duke i patur në qendër të vëmendjes këto dy elemente, ka ushtruar edhe kontrolle të herë pas herëshme në disa diga të mëdha. Gjatë këtyre inspektimeve dhe kontrolleve të kryera gjatë vitit 2022, vërehet me shqetësim se procesi i mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha në përgjithësi ka shumë të meta dhe mungesa në kryerjen e tyre. Mëse 90 % e shfrytëzuesve të digave, nuk kanë asnjë rregullore për mirëmbajtjen apo monitorimin e tyre. Njekohësisht, në të gjitha digat e mëdha që shfrytëzohen nga bashkitë, mungojnë instrumentat e monitorimit të digave. Në digat e mëdha që administrohen nga MBZHR jo vetëm nuk janë kryer punime për pastrimin e digave nga vegjetacionet (pemët apo shkurret), por nuk kryhen as matjet e instrumentave që janë të instaluar për monitorimin e tyre përmes projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Ekipet e drejtimit teknik dhe sigurisë së digave janë të pa trajnuar dhe nuk bëjnë asnjë analizë apo interpretim të këtyre të dhënave. Në rezervuarët e këtyre digave, nuk janë bërë asnjehere matjet e volumeve të ujit apo ndonjë analizë në lidhje me procesin e sedimentimit në to.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Procesi i kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së digave paraqitet më mirë në digat shumë të mëdha që shfrytëzohen për prodhim energjisë. Konkretisht, Shfrytëzuesit e digave KESH, Devolli HP, Ayen, Kurum, etj., kanë një sistem të plotë të kontrollit dhe monitorimit modern dhe në kohe reale të digës të pajisur me sistemet e duhura të kontrollit dhe monitorimit të saj. Këto shfrytëzues kanë organizuar njësitë teknike të shfrytëzimit dhe monitorimit të digave.

Nga ana tjetër, vihet re se shfrytëzues private të digave të mëdha për prodhim energjie (digat e HEC Lumzi, diga e HEC Murdhar, diga e HEC Okshtun, diga e HEC Osoja, diga e HEC Helmes, etj.), kryejnë një kontroll të thjeshtë vizual të gjëndjes dhe nuk kanë të instaluar sisteme monitorimi apo sisteme alarmi për rastet e emergjencave civile në zonat poshtë digave.

Në këto diga nuk ka asnjë të dhënë të monitorimit të tyre gjeodezik, hidrogjeologjik, meteorologjik apo gjeologjik.

E njëjta situatë është edhe për digat e mëdha që shfrytëzohen nga MBZHR si dhe digat e mëdha që përdoren për ujitje nga bashkitë e vendit. Sipas raportimeve dhe kontrolleve në vend, rezulton se mbi **97 % të digave të ujitjes që shfrytëzohen nga MBZHR dhe Bashkitë nuk kanë të instaluar sisteme të monitorimit të digave apo sisteme alarmi.** Në mënyrë të veçantë vihet re se bashkitë e 5 qarqeve (qarku Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Berat dhe Korçë), që kanë në përdorim mëse 60 % të digave të mëdha, jo vetëm që nuk kryejnë monitorim apo mirëmbajtje të digave, por nuk kanë përgatitur asnjë hartë të përmbytjeve në zonat poshtë tyre sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi të përshtatur me kushte aktuale të zonës poshtë digave. Kjo problematikë bëhet më e veçantë duke patur parasysh se popullsia në këto zona është shtuar shumë dhe rreziku është imediat dhe mjaft i madh. Theksojmë se në shumicën e digave që shfrytëzohen nga bordet e kullimit të MBZHR dhe të këtyre bashkive, nuk kryhen proceset e mirëmbajtjes së tyre të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi, gjë e cila ka sjellë mbushjen e digave me vegetacione (pemë dhe shkurre), që jo vetëm dëmtojnë trupin e digës por krijojnë premisa për rritjen e filtrimeve të ujit dhe uljen e jetëgjatësisë së tyre. Si shembull më tipik mund të përmenden digat e Gjançit dhe të Murriz- Thanë që administrohen nga MBZHR.

Një problem tjetër që vihet re tek shumë bashki është mungesa e njësive teknike për mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e digave. Prej vitit 2015 kur janë dorëzuar asetet e digave dhe të infrastrukturës ujore të tyre tek bashkitë, nuk është kryer asnjë trajnim i këtyre ekipeve në lidhje me mirëmbajtjen dhe monitorimin e digave. Shumë bashki nuk kanë kapacitetet e duhura si dhe dëshirën për të përgatitur rregulloret përkatëse për mirëmbajtjen dhe monitorimin e digave, duke qenë prej vitesh në shkelje të kërkesave të ligjit. Në shumicën e rezervuarëve të administruar nga këto bashki, nuk janë bërë matjet e volumeve të ujit në to dhe nuk ka asnjë informacion në lidhje me mbushjet e tyre. Bashkitë konstatojnë problemet me digat vetëm në rastet kur ato janë bërë emergjente dhe kërkojnë ndërhyrje të shpejta për zgjidhjen e problematikave të konstatuara të cilat në shumicën e rasteve janë zgjidhje afatshkurtra. Në të gjitha rastet e konstatuara nga KKDM, të mungesës së mirëmbajtjes, monitorimit apo mos përgatitjes së rregulloreve të shfrytëzimit të digave, është e pamundur të zbatohen penalitetet e kërkuara nga ligji për këto mungesa për shkak të mungesës së Inspektoriatit Teknik të digave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Për të dhënë një pasqyrë më të detajuar të situatës, po përshkruajme këtë proces sipas tipit të digave, përdorimit të tyre, rëndësisë dhe sigurisë që duhet të trajtohen dhe problematika që janë hasur si më poshtë,

- **Digat e mëdha që përdoren për prodhim energjie ujore**

Sipas rregjistrit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë **24 diga të mëdha** nga të cilat 7 diga të mëdha janë pjesë e Kaskadës së lumit Drinit të shfrytëzuara nga KESH dhe DITECO, 3 diga janë pjesë e kaskadës së lumit Devoll që shfrytëzohen nga Shoqëria DEVOLLI HP (Moglicë dhe Banjë) dhe shoqëria Favina (Osoja), 4 diga janë pjesë e kaskadës së lumenjve Mat dhe Fan të shfrytëzuara nga kompanite AYEN, KURUM, LUMZI, etj

- **Digat e mëdha për prodhim energjie të kaskadës së lumit Drin të administruara nga KESH sh.a.**

Kontrolli, monitorimi dhe siguria e 6 digave të mëdha në kaskadën e lumit Drin kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. KESH jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar në çdo digë sistemet bashkëkohore përkatëse të monitorimit

KESH ka hartuar rregulloret për shfrytëzimin e digave dhe shkarkimeve në rastet e plotave të mëdha. Në vitin 2015, KESH ka përgatitur edhe hartat e përmbytjeve për zonën poshtë digave dhe në vitet 2019-2021 kanë instaluar sistemet e alarmit sipas këtij Projekt-Planit të Emergjencave të hartuar. Në vitin 2022 janë përditesuar Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me skenarët përkatës.

Bazuar në studimet e mëparshme, në matjet e fundit të volumeve të ujit në të 3 ujëmbledhësit e krijuar si dhe në grumbullimin e të dhënave të shumta gjatë 35 viteve të fundit në lidhje me menaxhimin e integruar të ujrave të kaskadës si dhe problematikat që janë hasura nga përmbytjet në vitet 2010 dhe 2018, KKDM sugjeron që KESH duhet të ndërmarrë inisiativa profesionale të bazuar në ekspertiza të thelluara dhe të studjuara për përditesimin dhe përmirësimin e menaxhimit të integruar të Kaskadës dhe ngritjen në një stad bashkëkohor dhe eficient të menaxhimit të prurjeve të mëdha në kaskadën e lumit Drin. Këto ekspertiza mund të mbështeten në Udhezimet dhe rekomandimet e dhëna nga KKDM si dhe në buletinet e ICOLD Nr. 186 “Për menaxhimin e integruar të digave të kaskadës”, Nr. 187 “Për menaxhimin e rrezikut dhe përmbytjeve”, apo buletini Nr. 189 “Për rrezikun e informuar nga vendimarrësi për sigurinë e digave”.

Duke u bazuar në të gjitha të dhënat dhe studimet e deri sotme të kryera nga KESH, **KKDM rekomandon kryerjen e një rishikim dhe përditësimi profesional nga ekspertë me përvojë të Rregullores së Shkarkimit të Plotave në kaskadën e lumit Drin e hartuar në vitin 1988 duke e përshtatur me kushtet dhe metodat e sotme të menaxhimit të integruar të kaskadave si dhe ndryshimeve klimatike në vendin tonë.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

**Rishikimi i rregullores duhet të ketë si fokus rritjen e sigurisë së digave të kaskadës së lumit Drin, operimin optimal të integruar të ujëmbledhësive të kaskadës si dhe përgatitjen e moduleve të operimit duke kombinuar përfitimet nga hidroenergja me zvogëlimin e rriskut nga përmbytjet dhe përfitimet për kulturat bujqësore në tokat që ndodhen në zonat poshtë digave të HEC Vau i Dejës. Ky rishikim duhet të marrë në konsideratë edhe konkluzionet e dhëna nga ekspertet e huaj për rritjen e kapaciteteve të shkarkuesve në digat e HEC Fierzë dhe HEC Koman si dhe volumet aktuale të ujit në 3 rezervuarët e kaskadës së lumit Drin.**

**Kjo kërkesë bëhet edhe me aktuale në kushtet e zbatimit të projektit për HEC Skavica, ndërtimi të cilit do të kërkojë domosdoshmërisht miratimin e një rregullore të re të menaxhimit të integruar të kaskadës ku duhet të përfshihen edhe procesi i shkarkimit të plotave të mëdha si dhe bashkëpunimi me shfrytëzuesit e digave mbi lumin Drin i zi në të dy anët e kufirit. Në kuadër të hartimit dhe zbatimit të projektit të HEC Skavica, KKDM ka kërkuar pranë MIE edhe funksionimin e Komisioneve Ndërkufitare të ujrave me Maqedoninë e Veriut dhe me Kosovën për të bërë të mundur jo vetëm shfrytëzimin e përbashkët të ujrave të basenit ujëmbledhës të lumit Drin por edhe për bashkëpunimin institucional ndërqeveritar në lidhje me monitorimin dhe sigurinë e digave të kaskadës së lumit Drin dhe në mënyrë të veçantë për efektet e shfrytëzimit të digës së Spillje e cila ndodhet në Maqedoninë e Veriut në operimin e digës së HEC Skavicës dhe të të gjithë kaskadës së lumit Drin.**

**Theksojme se kaskada e Lumit Drin për vetë tipin e digave të ndërtuara, kompozicionin dhe basenet e krijuara, kapacitetet e instaluara të energjisë, dinamikën e përdorimit për shfrytëzimin e kësaj energjie, peshën specifike në prodhimin e energjisë dhe impaktin pozitiv në ekonomine e vendit është Unike në Europë. Gjithashtu, duke patur parasysh edhe faktin e Rrezikut të lartë human dhe ekonomik në raste të ndonjë dëmtimi të mundshëm natyror, do të kërkonim që kjo kaskadë të marrë statusin e veprave strategjike të rëndësishme shumë të veçantë e cila duhet të shoqërohet edhe me të gjitha masat organizative e teknike përkatëse dhe ekip të veçantë e të kualifikuar për monitorimin dhe analizën e të dhënave të marra online në kohë reale për të gjitha digat e kaskadës.**

Referuar Raportit Vjetor të KESH sh.a., gjatë vitit 2023 është parashikuar të kryhen matjet batimetrike të volumeve të ujit të tre rezervuarëve, punë kjo që duhet të kryhet në zbatim të rregullores përkatëse dhe kuadrit ligjor si dhe të studimeve dhe analizave të mëparshme. Referuar studimeve analizave dhe matjeve të kryera në vitin 2015, kapaciteti total i ujëmbledhësit të Fierzës deri në nivelin maksimal të operimit 296.00 mmnd, rezulton të jetë rreth 2.2 miliard m<sup>3</sup> ujë, 15 % më pak se volumi prej 2.7 miliard m<sup>3</sup> i dhënë në fazën e projektimit të veprës. Për sa me siper është e domosdoshme kryerja e matjeve të volumit aktual të ujit në keto rezervuare me instrumenta dhe metoda bashkëkohore si dhe reflektimi i të dhënave të këtyre matjeve në operimin dhe shfrytëzimin e kaskadës së lumit Drin

Nga kontrollat e kryera nga ekipi i sigurisë së digave në KESH, një problem që duhet të monitorohet me kujdes të vazhdueshëm në kohë reale dhe në mënyrë online, janë filtrimet në biefin e poshtëm të digës së Komanit, vlerat e të cilave janë shumë më të larta se vlerat e rekomanduara nga literatura ndërkombetare dhe rekomandimet e ICOLD.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

**KKDM ka kërkuar që procesi i kontrollit dhe monitorimit të sasisë së ujrave që filtrojnë në anën e poshtme të digës së HEC Koman si dhe turbullsia e tyre në kohë të ndryshme, duhet të kryhet në kohë reale, dhe KESH duhet të marrë masat e duhura të menjëherëshme për rehabilitimin e strukturës hidraulike të dëmtuar gjatë shkarkimeve të vitit 2022.** KKDM ka kërkuar që KESH të dërgojë raporte teknike të veçantë në lidhje me këto filtrime në KKDM dhe MIE çdo 6 muaj të cilat duhet të shoqërohen edhe me analizat përkatëse, ecurinë e procesit, konkluzione dhe rekomandimet përkatëse për të ardhmen, gjë e cila është realizuar përgjatë viti 2022.

Gjithashtu, KKDM sugjeron që KESH të kryejë studime më të detajuara dhe të thelluara me metoda bashkëkohore për përcaktimin e rrugëve të lëvizjes së ujrave nga liqeni përmes digës së HEC Koman në drejtim të anës së poshtme të saj.

Duhet theksuar se edhe gjatë vitit 2022, KESH ka kryer investime të mëdha për rehabilitimin e portave të sistemeve të shkarkimit, me qëllim rritjen e sigurisë së veprave në përgjithësi dhe operimit e sigurtë të tyre gjithashtu, duke përmirësuar edhe kushtet e punës në to. **KKDM po e ndjek me vëmendje investimet e kryera me financim të Bankës Botërore dhe KfW për të cilat ka kërkuar të mbikqyren dhe të kolaudohen sipas kërkesave të ligjit.** Gjithashtu, **KKDM ka kërkuar që dokumentacioni teknik i punimeve (sipas faktit) për punimet e kryera, duhet të dorëzohet në përputhje me kërkesat ligjore.** KKDM është në pritje të përmbushjes së këtij detyrimi nga KESH sh.a.

- **Digat e mëdha për prodhimin energjie të kaskadës së lumit Devoll të administruara nga Devolli HP/ Statcraft dhe Favina.**

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digave të HEC Banjë dhe HEC Moglicë kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Devolli HP/Statcraft jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar në çdo digë sistemet bashkëkohore përkatëse të monitorimit

Shoqëria Devolli HP/ Statcraft ka hartuar dhe miratuar rregulloret për shfrytëzimin e digave dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha. Në të dy digat e mëdha që administrohen prej tyre, janë instaluar sirenat e alarmit dhe kanë përgatitur Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me skenaret sipas kërkesave të ligjit.

Këto plane janë përgatitur duke u bazuar në të dhënat e projektit. Në vijim, KKDM kërkon të përgatiten Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile duke u bazuar në të dhënat teknike aktuale për të dy digat duke përfshirë gjendjen aktuale të digave, sistemet e monitorimit dhe të alarmit të instaluar në to, sëbashku me rregulloren e operimit dhe të mirëmbajtjes së tyre si dhe të sistemeve të shkarkimit. KKDM ka kërkuar përditësimin e Rregullores së Shfrytëzimit të digave bazuar në udhëzimet e reja të dhëna në lidhje me monitorimin e digave pas tërmetit.

**Ne vijim të problematikave të krijuar dhe të evidentuara në dy vitet e fundit, KKDM po ndjek me vëmendje kontrollin dhe monitorimin e digës së Moglicës gjatë vitit 2022 si dhe po analizon rezultatet e dhëna në raportet teknike përkatëse të Shfrytëzuesit të digës, KKDM ka kërkuar monitorimin e kujdesshem dhe të thelluar të problematikës në lidhje me uljet në kreshten e digës së Moglicës si dhe uljeve në pjesën e sipërme të trupit të digës.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM e ka ndjekur me përparësi procesin e monitorimit të kësaj problematike si dhe ka shqyrtuar analizën e kryer nga ekspertë të kualifikuar të shfrytëzuesit të digës në bazë të së cilës ka gjykuar se uljet e vërejtura në kreshtën e kësaj dige megjithëse janë shume me te vogla ne krahasim me vitet e mëparshme, vazhdojnë të jene problematike dhe kerkojne vazhdimin e nje monitorimi te hollesishem sidomos ne zonat ku ka ndodhur si edhe konfigurimit të tyre.

**Për sa më sipër, KKDM ka shqyrtuar me hollesi raportet teknike 6 mujore të shfrytëzuesit të digës në lidhje me ecurinë e kësaj ulje dhe ka kërkuar informacione më të shpeshta në lidhje me ecurinë e kësaj problematike. KKDM ka kërkuar vazhdimin e procesit të monitorimit dhe të analizës së thelluar të kësaj problematike. Në rastet se nga monitorimi i situatës vihen re përkeqësime, shfrytëzuesi i digës duhet të raportojë në kohë reale institucionet përkatëse.**

Gjithashtu, KKDM ka vërejtur se kontrolli, mirëmbajtja dhe monitorimi i diges se HEC Osojes qe ndodhet ne pjesen e siperme te lumit te Devollit ka probleme ne lidhje me sistemet e monitorimit, mungeses se nje rregulloreje te shfrutezimit te saj, zbatimin e kerkesave teknike si dhe te mosplotesimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kompania Favina shpk që administron dhe përdor këtë digë, kryen vetëm një kontroll vizual dhe nuk ka të instaluar instrumentat e duhura përkatëse të monitorimit te kerkuara sipas VKM perkatese. Kompania nuk ka të miratuar Rregulloren e Shfrytëzimit, operimit, mirëmbajtjes, monitorimit dhe Sigurisë së digës dhe nuk ka përgatitur hartat e përmbytjes në zonat poshtë digës. KKDM ka kërkuar përgatitjen e hartave të përmbytjeve dhe rregulloren e shkarkimit të plotave të mëdha duke u bazuar në prurjet maksimale të mundëshme, përfshirë edhe shkarkimet për shkak të prurjeve të mëdha që vijnë një herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet.

○ **Digat e mëdhe për prodhime energjie në lumin Fan dhe Mat të shfrytëzuar nga AYEN, Kurum dhe Lumzi MC.**

**Diga e HEC Ura e Fanit.** Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së HEC Ura e Fanit kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania AYEN jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar edhe instrumentat perkatese per monitorimin e diges. Ne baze te matjeve te kryera dhe raportit vjetor per vitin 2022, rezulton se ne kete dige ka probleme ne lidhje me filtrimet ne pjesen e poshtme te diges te cilat jane me te medha se vlerat e projektuara.

Kompania AYEN ka hartuar rregulloret për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet e plotave të mëdha e cila është aprovuar nga KKDM. Shfrytëzuesi i digës ka përgatitur hartat e përmbytjeve dhe Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruara me skenarët sipas kërkesave të ligjit dhe duke u bazuar në gjendjen faktike të diges.

**Diga e HEC Ulez dhe HEC Shkopet.** Kontrolli, monitorimi dhe siguria e digës së HEC Ulzës dhe HEC Shkopetit kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania KURUM jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar edhe sisteme të monitorimit të digës të cilat funksionojnë dhe japin të dhëna të rregullta. KURUM ka hartuar rregulloren për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve ne rastet e plotave të mëdha e cila është shqyrtuar në KKDM. Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për digat e Ulzës dhe Shkopetit, janë përditësuar duke marrë në konsideratë plotësimet dhe ndërhyrjet e kryera në digën e HEC Ulzës në vitin 2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

**Diga e HEC Lumzi.** Kontrolli, monitorimi dhe siguria e digës së HEC Lumzi **nuk kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania MC Inerte Lumzi jo vetëm që nuk kryen kontroll dhe monitorim me instrumenta sipas kërkesave teknike, por deri më sot nuk ka dorëzuar ndonjë Raport Vjetor në lidhje me gjendjen e digës apo monitorimin e saj. Në digën e Lumzi nuk ka të instaluar sisteme të monitorimit të digës.**

- **Digat e mëdha për prodhim energjie të administruara nga koncesionarë të tjerë.**

Bazuar në kontrollat e kryera nga strukturat e KKDM dhe raportimet e kërkuara nga shfrytëzuesit e digave, rezulton se kontrolli, mirëmbajtja dhe monitorimi i digave të HEC Helmes, Belesovë, Liqeni i zi, etj **nuk kryhen sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, udhëzimeve të KKDM dhe rekomandimeve të ICOLD. Ato kryejnë vetëm kontrolle vizuale dhe nuk kanë një baze të dhenash të matjeve të monitorimit me ane të instrumentave sipas kërkesave teknike. Asnjë prej shfrytëzuesve të mësipërme, nuk kanë hartuar një rregullore për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha.** KKDM ka kërkuar zyrtarisht plotësimin e saj me hartat e përmbajtjeve në zonën poshtë digës, llogaritjen e valës shkatërruese, matjet batimetrike për volumin e ujit në rezervuar, Pregatitjen e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile sipas legjislacionit në fuqi të shoqëruar me skenarët sipas kërkesave të ligjit. Të gjitha këto kërkesa nuk janë plotësuar akoma nga këta shfrytëzues dhe mungesa e ITD e bën të pamundur zbatimin e sanksioneve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

- **Digat e mëdha që përdoren për Furnizim me Ujë (Diga e Bovillës dhe e Manskurisë)**

Sipas rregjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë dy diga të mëdha që përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë urbane në qytetin e Tiranës dhe në Golem. Diga më e rëndësishme në këtë grup është diga e Bovillës me lartësi 91 m që përdoret për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së Bovillës kryhet nga ekip teknik i kualifikuar nën administrimin e UKT sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Bazuar në Kontrollin e kryer nga KKDM si dhe në korrespondencën e gjatë të KKDM në lidhje me problematikat e hasura ndër vite për shfrytëzimin dhe monitorimin e digës së Bovillës, KKDM i ka kërkuar UKT dhe Bashkisë Tiranë, një vëmendje më të madhe në lidhje me marrjen e disa masave thelbësore për sigurinë e kësaj dige edhe për vetë faktin që kjo digë është objekt i rëndësishëm së veçantë. Deri më sot, UKT ka marrë disa masa në lidhje me monitorimin e kësaj dige por vazhdon të jetë problem monitorimi i një masivi rrëshqitës në anën e djathtë të rezervuarit, i cili duhet të monitorohet me kujdes si dhe instalimi i sistemeve të monitorimit sizmik dhe hidrometeorologjik. Cështje që kërkon vëmendje dhe analize të thelluara është edhe procesi i sedimentimit në rezervuarin e kësaj dige.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Kontrolli, mirëmbajtja dhe monitorimi i digës së Manskurisë aktualisht kryhet nga UK Durrës, pas reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe bashkimit të ndërmarrjeve të UK Kavajë dhe UK Durrës. Në këtë digë janë kryer inspektime në bashkëpunim me drejtuesit e UK Durrës dhe janë konstatuar difekte të rënda dhe problematika të mëdha në trupin e digës. Kjo digë dhe rezervuari i krijuar prej saj, aktualisht mbahen në gjendje alarmi duke mbajtur të ulur nivelin e ujit në rezervuar dhe duke mos e përdorur për furnizim me ujë të zonës. Kjo gjendje problematike prej 7 vitesh është menduar ti jepet zgjidhje përmes hartimit të një projekti për rehabilitimin e digës dhe të impiantit të trajtimit të ujit që ndodhet poshtë saj. Në këtë digë nuk ka të instaluar sisteme monitorimi, sisteme alarmi dhe UK Durres kryen vetëm kontrole vizuale të gjendjes së digës. KKDM ka kërkuar përgatitjen e projektit të zbatimit për rehabilitimin e digës brenda vitit 2023 dhe një ndërhyrje inxhinierike sa më shpejt të jetë e mundur nga UK Durrës.

- **Digat e mëdha që përdoren për Ujitje dhe atraksione urbane e turistike nga Bashkitë dhe MBZHR,**

Sipas rregjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë 328 diga të mëdha që përdoren për ujitje dhe për atraksione urbane ku 8 prej tyre shfrytëzohen nga MBZHR dhe 320 diga të mëdha shfrytëzohen nga 54 pushtete lokale që i kanë marrë në administrim përmes VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015. Në vitin 2009, me financim të Bankës Botërore është kryer një studim për gjendjen e 195 digave të mëdha që përdoren për ujitje. Bazuar në këtë studim, janë kryer rehabilitimi i 14 digave të mëdha por në asnjë rast nuk janë instaluar sistemet e alarmit në diga megjithëse në studim janë dhënë hartat e përmbajtjeve të zonave poshtë tyre. Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, në disa diga janë instaluar sisteme të monitorimit por që deri më sot bashkitë që i administrojnë këto diga, nuk kanë një bazë të dhënash të monitorimit të tyre. Të gjitha digat e mëdha që përdoren për ujitje nga bashkitë e vendit, nuk kanë të instaluar sistemet e alarmit duke qenë në shkelje të kërkesave ligjore në fuqi. Në këto diga nuk ka ndërtesë të shërbimit dhe ruajtjes së digë siç kërkohet në VKM Nr. 147, neni 29.

Sipas raportit vjetor të MBZHR për gjendjen e digave në vitin 2022, kjo ministri na informon se është në negociim me Bankën Botërore në lidhje me një studim që mund të kryhet në të ardhmen për gjendjen e mëse 420 digave të mëdha dhe të vogla përmes një financimi prej afro 130 milion USD.

Per sa më sipër, **KKDM rekomandon se inspektimi për gjendjen e digave të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim, mund të kryhet nga specialistë shqiptarë duke u bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për digat** si dhe aktet e tjera nënligjore. Bazuar në këtë legjislacion, shfrytëzuesit e digave në bashkëpunim me Ministrinë e linjës dhe KKDM, çdo 10 vjet duhet të kryejë kontrollin teknik të digave. Ky kontroll deri më sot nuk është kryer. Për ti dhënë një zgjidhje sa më të shpejtë këtij problemi, KKDM rekomandon që ky kontroll mund të kryhet nga ekspertë të Insitutit të Ndërtimit i cili është strukturë shtetërore e MIE në bashkëpunim me specialistë shqiptarë të fushës, kundrejt marrëveshjeve përkatëse. Kjo mënyrë kontrolli jo vetëm që do të kursej fondet e shumta të parashikuara për këtë project, por edhe do të japë mundësinë e dhënies së konsulences nga ekspertët shqiptarë që i kanë projektuar ato ndër vite apo inxhinierë të fushës me eksperiencë në këtë fushë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Problemi kryesor që vazhdon të jetë për digat e mëdha që përdoren për ujitje nga bashkitë është mungesa e mirëmbajtjes së tyre, mungesa e sistemeve të monitorimit të digave, mungesa e ekipeve teknike të kualifikuara, mungesa e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe e hartave të permbytjeve në zonat urbane poshte digave. Me poshte po analizojme në detaje gjendjen aktuale të digave dhe monitorimit të tyre nga dy shfrytëzuesit kryesorë si:

○ **Digat e mëdha për ujitje që shfrytëzohen nga MBZHR**

Kontrulli, mirëmbajtja, monitorimi dhe siguria e këtyre digave, kryhet nga ekipe teknike të 4 bordeve të kullimit të MBZHR që ndodhen në Fier, Durrës, Korçë dhe Lezhë. Këto ekipe kryejnë vetëm kontrole vizuale sipas disa udhëzimeve teknike të hartuar nga MBZHR por nuk kryejnë monitorim me instrumenta të digave siç kërkohet në VKM Nr. 147, neni 31 dhe 32. Në kuadër të projektit të financuar nga BB, janë instaluar instrumenta të monitorimit të digave në 4 prej këtyre digave, por akoma nuk është hartuar ndonjë program i veçantë për mirëmbajtjen dhe monitorimin e tyre nga bordet e kullimit të MBZHR. Deri më sot bordet e kullimit që i administrojnë këto diga dhe MBZHR si Ministri përgjegjëse për përdorimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e këtyre 8 digave, nuk kanë asnjë bazë të dhënash të monitorimit të tyre. Të gjitha digat e mëdha që përdoren dhe administrohen nga kjo Ministri, nuk kanë të instaluar sistemet e alarmit dhe nuk kanë të përgatitur dhe të miratuar ndonjë plan të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile duke qenë në shkelje të kërkesave ligjore në fuqi të përmendura më sipër.

Bazuar në Informacionet e marra si dhe nga kontrollet e ushtruara në terren nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në lidhje me problematikat e hasura gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të digave të Ujitjes të administruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), verehet se:

- **Mungojnë Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile** për të gjitha digat që janë nën administrimin e MBZHR. Në zbatim të Ligjit Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Rregullore për Sigurinë e Digave dhe Dambave” kërkohet hartimi i këtyre planeve nga shfrytëzuesit e digave dhe miratimi i tyre nga KKDM. Deri me sot, megjithë kërkesat e përsëritura të KKDM si dhe kërkesat ligjore për hartimin e planit të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për digat që shfrytëzohen nga kjo Ministri, akoma nuk është dërguar ndonjë dokument i tillë pranë KKDM për miratim. Duke patur parasysh madhësinë e këtyre digave, numrin e madh të banorëve në zonat urbane poshte tyre si dhe rrezikun në raste të dëmtimit apo prishjes së mundshme të ndonjë digë kërkohet të hartohen planet e alarmit dhe të evakuimit duke përfshirë edhe studimin për përhapjen e vales shkatërruese në luginën poshte digës sipas kërkesave teknike si dhe hartimin e planit të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile.
- **Mungojnë sistemet e alarmit në trupin e digave** sipas kërkesave të legjislativës në fuqi dhe udhëzimeve të ICOLD dhe të KKDM. Duke patur parasysh ndërtime të shumta në zonën poshte digave si dhe numrin e madh të njerëzve në rrezik që banojnë poshte tyre, instalimi i sistemeve të tilla moderne është një domosdoshmëri urgjente dhe ligjore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Mungojnë matjet e sedimenteve në rezervuaret e krijuar** nga këto diga dhe kryerja e matjeve batimetrike të volumeve të ujëmbledhësit. Megjithatë sipas VKM Nr. 147, date 18.03.2004, neni 30, këto matje duhet të bëhen të paktën një herë në 10 vjet, deri më sot këto matje nuk janë kryer asnjehere në shumicën e digave të mëdha që administrohen nga kjo Ministri. Problemi behet më i mprehtë duke patur parasysh faktin se këto diga janë ndërtuar para me shumë se 50 vitesh dhe fenomeni i mbushjes me sedimente është mjaft i dukshëm për të cilin kërkohej një analizë dhe konkluzione sa më të shpejta për të anulaizuar me tej jetegjatesinë e tyre dhe masat që duhet të merren për të ardhmen.
- **Mungojnë monitorimi me instrumenta sipas kërkesave teknike dhe udhëzimeve të KKDM** si dhe përpunimi dhe analiza e matjeve të monitorimit gjeologjik, gjedoezik, hidraulik dhe hidrometeorologjik në lidhje me uljet e mundshme të diges, filtrimet ujrave, rrëshqitjet, lëvizjet lokale në trupin e digave dhe në shpatet e tyre. Njohja e fenomeneve që ndodhin në diga si dhe të gjëndjes së tyre shërben jo vetëm për rritjen e sigurisë së digave por edhe për analizimin e problematikave që mund të kenë ndodhur gjatë viteve të operimit dhe shfrytëzimit të saj. Kjo lidhet edhe me faktin e moshës së vjetër të ndërtimit të këtyre digave shumica e të cilave janë ndërtuar me shumë se 50 vite më parë dhe me teknologji të vjetëruara të viteve 1960-1970. Problematika behet më e madhe duke u nisur edhe nga fakti i mungesës së mirëmbajtjes dhe monitorimit të tyre si dhe nga fakti i popullimit të zonës urbane poshtë tyre.

Për sa më sipër, KKDM ka kërkuar disa herë marrjen e masave përkatese për zgjidhjen e problematikave të mësipërme të shoqëruara me një program të detajuar pune për realizimin e këtyre masave të kërkuara me sipër në përputhje me legjislacionin në fuqi. Deri më sot, nuk ka një përgjigje pozitive dhe një anagzhim serioz nga ana MBZHR për rregullimin e gjëndjes.

- **Digat e mëdha për ujitje dhe zhvillim urban të shfrytëzuara nga Bashkia e Tiranës.**

Bashkia e Tiranës është përdoruesi më i madh i digave të ujitjes, peshkimit dhe për zhvillimin urban të zonës duke patur nën administrim **38 diga të mëdha** (Diga e liqenit artificial të Tiranës dhe e Bovillës administrohet nga UKT).

Kontrolli, monitorimi dhe siguria e këtyre digave kryhet nga një sektor teknik i Bashkisë Tiranë. Këto ekipe kryejnë vetëm kontrolle vizual por **në asnjë digë që përdoret nga kjo Bashki, nuk ka të instaluar instrumenta të monitorimit të digave apo sisteme alarmi siç kërkohej në VKM nr. 147, neni 31 dhe 32.**

Në asnjë digë nuk ka ndërtesa të shërbimit dhe kontrollit të digave si objekte të rëndësishme së veçantë të kërkuara në VKM përkatese. Nga kontrollet e ushtruara në terren nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në lidhje me problematikave të hasura gjatë shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave të mëdha të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë vërehet se:

- **Ne shumicën e digave të mëdha mungojnë hartat e permytjeve në rastet e prurjeve të mëdha apo prishjes së mundshme të digave si dhe Planet e gadishmerisë në rastet e emergjencave civile.** Duke patur parasysh popullimin e zonave urbane poshtë digave si dhe rrezikun e demtimeve apo humbjeve të njerezve në rastet e demtimeve dhe prishjeve të këtyre digave, është e domosdoshme dhe urgjente përgatitja e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Mungojne sistemet e alarmit në trupin e digave** apo sistemet e lajmerimit te termeteve. Duke patur paraysh ndertimet e shumta ne zonen poshte digave si dhe numrin e madh te njerezve ne rrezik qe banojne poshte tyre, instalimi i sistemeve te tilla moderne eshte nje domosdoshmeri urgjente dhe ligjore.
- **Mungojnë instrumentat për matjet dhe monitorimin e digave sipas standarteve teknike, kerkesave te nenit 32 te VKM perkatese si dhe përpunimi i të dhënave të monitorimit ndër vite.**
- **Mungojnë matjet e sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga** dhe kryerja e matjeve batimetrike të volumeve të rezervuareve të krijuar nga këto diga sipas kerkesave te nenit 30 te VKM perkatese.
- Inxhinieret dhe antarët e tjerë të ekipit të sigurisë së digave, nuk janë në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 147, neni 5 I cili kerkon qe ne keto ekipe duhet te kete inxhiniere te kualifikuar dhe me licencat perkatese te dhena nga MIE,
- **Mungojnë dokumentacioni teknik i mëse 20 digave të mëdha të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë.**

Për sa më sipër, KKDM ka kërkuar zyrtarisht marrjen e masave përkatëse për zgjidhjen e problematikave të mësipërme të shoqëruara me një program të detajuar pune për realizimin e këtyre masave të kërkuara me sipër në përputhje me legjislacionin në fuqi. Deri më sot, Bashkia e Tiranës nuk i është përgjigjur këtyre kërkesave dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap për zgjidhjen e këtyre çështjeve të rëndësishme në sektorin e digave. Sipas disa burimeve mediatike, kohët e fundit, Bashkia e Tiranës ka hartuar termat e referencës për të kryer studime dhe analiza për gjendjen e digave të mëdha që përdoren nga kjo bashki, por KKDM nuk është lajmëruar për këtë proces.

Siç e kemi theksuar edhe më sipër, **Bashkia Tiranë nuk ka plotësuar detyrimin ligjor** që brenda muajit Mars 2023 të dorëzoj pranë KKDM Raportin Vjetor të vitit 2022 për gjendjen, mirëmbajtjen dhe monitorimin e digave që ka nën administrim. Ende sot nuk është dorëzuar ndonjë raport për gjendjen e digave.

## 6. Programi dhe aktivitetet e KKDM gjatë vitit 2022.

Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit Nr.108, datë 13.08.2020, si dhe në Urdhërin e Ministres së MIE të datës 11.09.2020, u bë rikonstituimi i ekipit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) dhe KTPD i cili sipas legjislacionit në fuqi përbëhet nga 11 Antarë të KKDM dhe 5 antarë të KTPD.

KKDM ka zhvilluar aktivitetet e saj gjatë të gjithë vitit në mënyrë normale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe programin e punës për vitin 2022 të miratuar në Dhjetor 2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Në këto aktivitete kanë qenë të përfshira

- Organizimi i mbledhjeve të rregullta mujore gjatë të gjithë vitit nën drejtimin e Kryetarit të saj për të marrë vendime lidhur me të gjitha funksionet dhe detyrat e ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi.
- Inspektime dhe kontrole në terren sëbashku me shfrytëzuesit e digave për tu njohur me gjendjen aktuale të tyre, me monitorimin e digave dhe masat e marra për mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave.
- Takime pune me shfrytëzuesit e digave.
- Takime pune me Prefektët e Qarqeve kryesore të vendit për të shqyrtuar masat e marra në lidhje me planin e gadishmërisë për rastet e emergjencave civile.
- Takime pune me përfaqesues të institucioneve kryesore si MIE, MBZHR, Ministria e Mbrojtjes, AMBU, etj., për të diskutuar në lidhje me problematikat e ndryshme për monitorimin dhe sigurinë e digave.
- Përfaqësim i Shqipërisë në Kongresin e 27 të ICOLD.
- Pjesëmarrje në takime pune me përfaqesues të komiteteve të digave homologe si ITCOLD, SLOCOLD, MACOLD, GRCOLD dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me këto komitete.
- Botimi i librit “Digat Kryesore në Shqipëri” në bashkëpunim me Arkivën Qendrore Teknike.
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me Akademinë e Shkencave për promovimin e sektorit të digave në Shqipëri.

Për realizimin e aktiviteteve të mësipërme, KKDM është mbështetur nga Keshilli Teknik i Përhershëm i digave të mëdha, si organi këshillimor i tij. Duhet të theksojmë se për shkak të vendimeve të Ministrisë së Financave, përfshirja e këtij këshilli, nuk ka qenë i plotë gjatë të gjithë vitit 2022. Mendojmë se duke u bazuar në VKM për funksionimin e KKKDM dhe KTPD, aktivitetet e këtij Keshilli duhet të parashikohen për tu kryer gjatë të gjithë vitit dhe jo vetëm në 6 muajt e tij.

Siç theksuam më sipër, gjatë vitit 2022, KKDM ka organizuar takimet e punës çdo muaj ku janë marrë vendimet përkatëse.

Në këto takime janë shqyrtuar dhe analizuar çështjet kryesore si më poshtë:

- Shqyrtimi i problematikës së uljeve në digën e HEC Moglicës.
- Shqyrtimi i Raportit të SHGJSH në lidhje me problematikat e qendrueshmërisë së digave.
- Shqyrtimi i projektit të zbatimit për rehabilitimin e portave të remontit në digën e Qyrsaqit.
- Shqyrtimi i projektit të zbatimit për rehabilitimin e tunelit të shkarkimit të digës së Zadejës.
- Shqyrtimi i Raportit Vjetor për gjendjen dhe monitorimin e digave gjatë vitit 2021.
- Shqyrtimi i rregullores së shfrytëzimit të digave në bashkinë Devoll.
- Analiza e raportit vjetor për gjendjen dhe monitorimin e digave në bashkitë Elbasan, Pogradec, Gjirokastrë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Analizimi i Raportit Vjetor të bashkisë Tiranë për gjendjen dhe monitorimin e digave.
- Shqyrtimi i problematikave në digën e Xhafzotaj në lidhje me projektin e linjës së TM në afërsi të saj.
- Analizimi i Raportit Vjetor të Devolli HP për gjendjen dhe monitorimin e digave të Moglicës dhe Banjës.
- Analizimi i Raportit Vjetor për gjendjen e digave të mëdha që administrohen nga UK Tirana.
- Analiza dhe shqyrtimi i përmirësimeve dhe përditësimi i legjislacionit aktual në sektorin e digave.
- Aprovimi i temave që do të trajtohen në Kongresin e 28 të ICOLD.
- Miratimi i kolaudimit të punimeve për rehabilitimin e digës së Janjarit dhe Shtodrit.
- Shqyrtimi i kolaudimit të punimeve për digën e Tapizë.
- Shqyrtimi i kolaudimit të digës së HEC Lumzi.
- Shqyrtimi i problematikave që kanë nxjerrë jashtë pune digën e Vasjarit.
- Shqyrtimi i projektit të zbatimit për rehabilitimin e digës së Pacomitit në Përmet.
- Miratimi i projektit të zbatimit për rehabilitimin e digës së Çekrezës.
- Miratimi i projektit të zbatimit për rehabilitimin e digës së Libofshës.
- Shqyrtimi i problematikave në lidhje me mungesën e rregulloreve të shfrytëzimit, monitorimit dhe mirëmbajtjes së digave të ujitjes.
- Shqyrtimi i problematikave në digën e Gjançit në lidhje me mungesën e mirëmbajtjes së kësaj dige dhe mungesën e matjeve të monitorimit të digës.
- Shqyrtimi dhe analiza e raportit të MBZHR për gjendjen e digave në 6 mujorin e parë të vitit 2022.
- Shqyrtimi dhe analiza e problematikave në lidhje me arkivimin e dokumentacionit teknik të digave pranë SKDM dhe KKDM.
- Shqyrtimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me Planin Kombëtarë për Vlerësimin e Rrishtit nga Fatkeqësitë në nivel qendror.
- Miratimi i raportit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në lidhje me vlerësimin e rrishtit nga fatkeqësitë.
- Miratimi i rregullores së shfrytëzimit dhe monitorimit të digave të HEC Banjës, Fangut, Okshtunit dhe digës së Bovillës.
- Miratimi i programit dhe ekipit të kontrollit teknik 5 vjeçar për 4 digat e HEC Banjë, Murdhar, Lumzi dhe Fangut.
- Aprovimi i Rregjistrimit Kombëtar të digave të mëdha që janë përdorur gjatë vitit 2022.
- Miratimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruara me komitetet homologe të digave ITCOLD, SLOCOLD, MACOLD.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## 7. Përfundime për situatën në sektorin e digave të mëdha dhe dambave.

Gjatë shqyrtimit dhe analizës së kryer nga KKDM në lidhje me situatën aktuale në sektorin e digave të mëdha dhe dambave, është arritur në disa konkluzione si më poshtë:

- **Shumica e digave shumë të mëdha që përdoren për prodhim të energjisë ujore, janë në monitorim dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Problematike vazhdon të jetë monitorimi i disa digave të mëdha që administrohen me konçesion nga kompani private të vogla.**
- **Shumica e Shfrytëzuesve të digave të mëdha që përdoren për qëllime ujitje nuk kanë njesitë e drejtimit teknik për kontrollin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha gjatë shfrytëzimit duke mos respektuar kërkesat e nenit 29 të VKM nr. 147, datë 18.03.2004. Është një kërkesë urgjente që shfrytëzuesit e digave të mësipërme të krijojnë urgjentisht pozicionin e inxhinierit të digës/ njesisë së drejtimit teknik për sigurinë e digave me specialiste të kualifikuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë të gjitha detyrat dhe të drejtat e tyre gjatë procesit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së digës.**
- **Shumica e shfrytëzuesve të digave të mëdha që përdoren për qëllime ujitje, nuk kanë dokumentacionin teknik të projekteve të zbatimit të punimeve për digat / Pasaportat e digave.**
- **Kontrolli i shtetit përmes KKDM ndaj shfrytëzuesve të digave të mëdha sipas kërkesave të ligjit, është kryer me vështirësi dhe i shoqëruar me probleme të shumta që lidhen kryesisht me mungesën e inspektoriatit teknik të digave, mungesat logjistike në lidhje me kontrollin në terren, mungesat e informacioneve nga shfrytëzuesve të digave sipas kërkesave të legjislacionit si dhe mungesat e një baze të dhënash të monitorimit të tyre.**
- **Në sektorin e digave të mëdha ka mungesa të standardeve teknike në;**
  - **Në drejtim të mbrojtjes antisizmike gjatë projektimit dhe ndërtimit të veprave hidroteknike dhe digave të reja si dhe atyre ekzistuese.**
  - **në drejtim të projektimit dhe rivlerësimit të digave me materiale vendi që janë të vjetëruara dhe jashtë funksionit të përdorimit të tyre në kushtet aktuale.**
  - **Në drejtim të monitorimit të digave dhe dekomisionimit të digave të vjetra që janë jashtë funksionit.**
  - **Në drejtim të projektimit të digave me material RCC.**
- **Përmirësimi i situatës kërkon një riorganizim institucional të sektorit dhe rritje të përgjegjësisë së shfrytëzuesve të digave. Deri me sot, për shkak të mungesës së Inspektoriatit Teknik të Digave pranë MIE, nuk është kryer asnjë kontroll për gjendjen e digave, monitorimin dhe sigurinë e tyre siç kërkohet në VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, neni 37. Theksojmë se mungesa e këtij inspektoriatit që duhet të jetë nën varësinë e MIE, ka krijuar probleme të mëdha sidomos në kontrollin e punimeve të rehabilitimit të digave dhe në kolaudimin e tyre, në kontrollin e monitorimit të digave gjatë shfrytëzimit të tyre si dhe në informacionin për gjendjen e digave që duhet të jetë pranë KKDM.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Shfrytëzuesit e digave dhe rezervuarëve që përdoren për ujitje, nuk kanë matje të volumit të ujit në rezervuarët e krijuar nga këto diga që prej mëse 30 vitesh, duke mos respektuar kërkesat e nenit 30 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, sipas të cilës këto matje duhet të kryhen jo më vonë se çdo 5 vjet. Kjo situatë ka krijuar problematika të medha në menaxhimin e rezervave ujore në ujembledhësit e tyre. Kjo situatë duhet përmirësuar edhe për faktin se sipas inspektimeve në terren, volumi i ujit në këto rezervuarë vlerësohet të jetë më pak se 50 % e volumit të projektuar për shkak të sedimenteve të ardhura në to duke krijuar probleme në sasinë e ujit që kërkohet për ujitjen e tokave poshtë këtyre digave.**
- **Digat duhet të konsiderohen realisht si objekte të rëndësise se vecante dhe me rrisht të lartë në rast të dëmtimeve apo prishjeve që mund t’ju ndodhin. Shfrytëzuesit e digave duhet të marrin masat e duhura dhe të kenë prioritet plotësimin e kërkesave të percaktuara në Raportin e Konsoliduar për vlerësimin e Riskut të Fatkeqesive në Shqipëri të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në lidhje me carjet e digave.**
- **Mungon vlerësimi dhe rregjistrimi i aseteve të digave të medha që shfrytëzohen nga bashkitë dhe nga MBZHR. Mëse 90 % e shfrytëzuesve të digave, nuk e kanë të llogaritur vlerën e pasurive të paluajtshme për digat dhe rezervuarët e krijuar prej tyre. Ato nuk i kanë të rregjistruara digat dhe rezervuarët në Agjencinë kombëtare të Kadastres;**
- Në shumicën e digave të medha nuk ka të instaluar sisteme të alarmit. Vetëm në 50 % të digave të mëdha që përdoren për prodhim energjie janë të instaluar sisteme alarmi në diga dhe janë të përgatitura hartat e përmbytjeve për zonat e poshtme të digave në rastet e dëmtimeve të mundshme të tyre gjatë ngjarjeve katastrofike të natyrës apo të shfrytëzimit të tyre; Edhe për digat që kanë të instaluar sisteme të alarmit, shfrytëzuesit e tyre nuk kryejnë testime të rregullta për funksionimin e tyre. Mëse 98 % e digave të mëdha që përdoren për ujitje nuk kanë të instaluar sisteme alarmi në diga dhe nuk kanë ndërtesat e kërkuara për kontrollin dhe shërbimin e ruajtjes së digave. Më e theksuar kjo problematikë është në digat që administrohen nga MBZHR dhe nga Bashkitë e digave të mëdha që përdoren për qëllime ujitje.
- Shfrytëzuesit e 95 % të digave të mëdha që përdoren për ujitje, nuk kanë përgatitur hartat e përmbytjeve në rastet e prurjeve katastrofike apo të prishjeve të mundshme të ndonjë dige duke mos respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në kushtet e popullimit të shumë zonave poshtë digave si dhe të problematikave të vete digave, është bere e domosdoshme përgatitja e këtyre hartave dhe krijimi i rregulloreve dhe vendimeve përkatëse për të marrë masat e duhura për të mos lejuar ndertime të reja në këto zona si dhe përgatitjen e planeve urbanistike që të marrin në konsideratë problemet që mund të ndodhin nga prishjet e digave.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

**8. Rekomandime kryesore për përmirësimin e situatës në të ardhmen.**

**Bazuar ne konkluzionet e mesiperme si dhe tek legjislacioni ne fuqi, KKDM rekomandon**

- Në sektorin e digave duhet të kryhet një reformë e plotë institucionale, legjislative dhe organizative me synimin e përmirësimit të situatës problematike që ndodhet ky sektor, përshtatjes me zhvillimet e reja në këtë sektor në vendin tonë, përshtatjes me eksperiencat e vendeve europiane në sektorin e digave si dhe fuqizimin e kontrollit të shtetit në sektorin e digave. Kjo reformë duhet të konsistojë në ristrukturimin e sektorit të kontrollit shtetëror dhe menaxhimit të digave, në rishikimin dhe fuqizimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi duke bërë të mundur rritjen e vëmendjes në këtë sektor dhe ushtrimin e një kontrolli të vecantë. **Është e domosdoshme të merret eksperiencia europiane për krijimin e një autoriteti të sigurisë së digave të mëdha i cili të ketë detyra të qarta për kontrollin e shtetit për gjendjen e digave, monitorimin e tyre dhe miratimin e projekteve të ndërtimit të digave të reja dhe rehabilitimit të digave ekzistuese.** Ky autoritet mund të organizohet në strukturat e Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, Ministrisë së Mjedisit ose të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Në planin afatgjatë duhet të rishikohen dhe të përditesohet aktet ligjore dhe nënligjore në sektorin e digave të mëdha.
- **Ligji Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, duhet të përditesohen në funksion të kushteve dhe zhvillimeve të reja në sektorin e digave.** Gjatë kësaj periudhe kohore prej mëse 20 vitesh, kanë ndodhur ndryshime në pronësinë dhe shfrytëzimin e digave të mëdha, ndryshime dhe rritje të kërkesave për monitorimin dhe mirëmbajtjen e digave të mëdha, ndryshimet dhe rritje të kërkesave për sigurinë e digave, kërkesat për standartet teknike, ndryshime dhe rritje të kërkesave për masat që duhet të merren për gadishmerinë në rastet e emergjencave civile, ndryshime në legjislacionin përkatës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore apo për mbrojtjen civile. Bazuar në këto kërkesa si dhe në rekomandimet e ICOLD, KKDM rekomandon domosdoshmërinë e përditesimit të legjislacionit në fuqi duke përfshirë përfshirjen e klasifikimit të digave sipas rrezikut në zonat urbane poshtë tyre, kërkesat teknike për rehabilitimin e tyre, përshtatjen me ligjet e reja të miratuara në 10 vitet e fundit që lidhen me monitorimin dhe sigurinë e digave, organizimin e KKDM dhe institucioneve në varësi të saj në përshtatje me eksperiencën e vendeve europiane si dhe masat përkatëse penalizuese për shfrytëzuesit e digave që nuk plotësojnë kërkesat e ligjit në fuqi.
- MIE në bashkëpunim me Institucione teknike dhe shkencore, Akademinë e shkencave si dhe kompani konsulente me eksperiencë të hartohen standarte teknike të përmendura me kapitullin e konkluzioneve duke u bazuar në rekomandimet e ICOLD si dhe në standartet teknike të vendeve europiane me eksperiencë në këto fusha.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **MIE ne bashkepunim me KKDM duhet të shqyrtoj mundesitë për krijimin dhe funksionimin e një ekipi për kryerjen e kontrollit shtetëror teknik 10 vjeçar të digave. Si zgjidhje emergjente, rekomandojmë që të shikohet mundësia e kryerjes së këtij kontrolli nga Instituti i Ndertimit i cili jo vetëm që është pjese e strukturave te MIE por ka edhe kapacitetet teknike të nevojshme për kryerjen e këtij kontrolli. KKDM është e gatshme të kontribuojë dhe të bashkëpunojë në këto kontrolle teknike duke përgatitur udhëzuesit përkatës dhe rregullat që duhet të zbatohen gjatë këtyre kontrolleve si dhe shqyrtimin dhe miratimin e raporteve të kontrollit.**
- **Shfrytëzuesit e digave te ujitjes në bashkëpunim me prefekturat dhe MBZHR të kryejnë procesin e vlerësimit dhe rregjistrimit të aseteve të digave dhe të hartohet një regjistër kombëtar i vlerës së këtyre aseteve**
- Shfrytëzuesit e digave të mëdha që përdoren për ujitje në bashkëpunim me MBZHR, duhet të organizojnë procesin e përgatitjes së dokomunetacionit teknik të këtyre digave sipas udhëzimeve të dhëna nga KKDM. Ky proces duhet të shoqerohet edhe me një proces për përditesimin e të dhënave teknike të këtyre dosjeve përmes matjeve në terren.
- Bashkitë në bashkëpunim me MBZHR duhet të organizojne trajnime të stafeve teknike për monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha.
- **Problematika e mungeses se matjeve te volumeve faktike të ujit në rezervuarë duhet të zgjidhet sa me shpejt te jete e mundur nga shfrytezuesit e digave te medha përmes kryerjes së matjeve batimetrike në rezervuarët e krijuar prej tyre për të patur një pasqyrë aktuale të volumeve të ujit dhe për të hartuar një plan menaxhimi te ujit te grumbulluar si dhe nje bilanc real të rezervave ujore të tyre. Keto matje duhet te kryhen brenda vitit 2023 bazuar ne prioritetet qe lidhen me gjendjen dhe vjetersine e ketyre rezervuareve, madhesise se tyre si dhe rrisqeve qe mund te krijohen ne zonat poshte tyre**
- Problematika e mungesës së planeve të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile dhe e hartave të përmbytjeve duhet të zgjidhet sa më shpejt nga shfrytëzuesit e digave. Njëkohësisht, institucioneve përkatëse shtetërore duhet të rrisin masat penalizuese për mungesën e ketyre planeve nga shfrytëzuesit e digave. Përgatitja e hartave të përmbytjeve është e lidhur me masat që duhet të merren për sigurinë e banorëve që ndodhen në zonat urbane poshtë digave. Duke qenë se këto diga shfrytëzohen nga 54 bashki, theksojmë se përgatitja e hartave të përmbytjeve dhe Planeve të Gadishmërisë, mund të kryhet gjatë vitit 2023 duke përdorur fondet e dhëna nga buxheti i shtetit për emergjencat civile në çdo bashki.
- Shfrytëzuesi i digës së HEC Moglicës (Devolli HP) duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e uljeve në kurorën e digës së Moglicës sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KKDM dhe të informojë me raporte teknike të veçanta çdo 6 muaj KKDM, MIE dhe Këshillin e Ministrave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Shfrytëzuesi i digave të kaskadës së lumit Drin (KESH sh.a.) duhet të përditësojë rregulloren e shkarkimit të plotave me fokus rritjen e sigurisë së digave të kaskadës së lumit Drin, menaxhimin e integruar të kësaj kaskade si dhe zvogelimin e rrishtit të permbytjeve në zonën e poshtme të digave të HEC Vau I dejes. Në këtë kuader, KESH duhet të kryejë brenda vitit 2023 matjet e volumeve të ujit në të tre rezervuarët e krijuar në lumin Drin dhe në bazë të këtyre matjeve dhe studimeve të kryera deri më sot, të rishikojë dhe të përditësojë rregulloren e shkarkimit të plotave të përmendur më sipër.
- Shfrytëzuesi i digës së HEC Komanit (KESH sh.a.) duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e filtrimeve në biefin e poshtëm të digës së HEC Koman sipas rekomandimeve të dhëna nga KKDM që prej fillimit të monitorimit të tyre duke dhënë edhe rezultatet e të dhënave të monitorimit, analizat teknike dhe përfundimet përkatëse në lidhje me ecurinë e filtrimeve në këtë zonë si dhe fenomenet shoqëruese që mund të ndodhin duke përfshirë edhe turbullsinë e këtyre ujrave. KESH duhet të informojë me raporte teknike të veçanta çdo 6 muaj KKDM dhe MIE në lidhje me këtë problematikë dhe rezultatet e monitorimit të këtyre filtrimeve.
- Shfrytëzuesit e digave shumë të mëdha në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile duhet të kryejnë trainime dhe praktika në terren për zbatimin e detyrave të kërkuara nga Planeti e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile. Shfrytëzuesit e këtyre digave përmes një koordinimi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile duhet të kryejnë testimin e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile përpara sezonit të dimrit;
- MBZHR në bashkëpunim me bashkitë që janë shfrytëzues të digave të mëdha, duhet të përgatisin inventarin e digave të mëdha që kanë dalë jashtë funksionit dhe kanë nevojë për projektet e duhura dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për dekomisionimin e tyre. KKDM është e gatshme të ndihmojë dhe mbështesë këtë proces me hartimin dhe aprovimin e standarteve teknike përkatëse të bazuar në rekomandimet e ICOLD dhe në eksperiencat më të mira evropiane në këtë drejtim.
- MBZHR dhe MIE duhet të marrë masat e duhura për të kryer kontrollin dhe analizën teknike të specializuar me ekspertë të kualifikuar për të gjitha digat për qëllime ujitje me vjetërsi mbi 50 vjeçare.
- Shfrytëzuesit e digave që përdoren për qëllime të ujitjes, duhet të bëjnë klasifikimin e digave sipas rrishtit të tyre në zonat urbane, që ndodhen poshtë tyre duke u bazuar në Udhezimet e KKDM dhe rekomandimeve të ICOLD në lidhje me përcaktimin e zonave të rrezikuara dhe llogaritjet përkatëse për përgatitjen e hartave të permbytjeve. Shfrytëzuesit e digave të mësipërme të marrin masat e duhura për kontrollin dhe monitorimin e digave përmes pozicionit të inxhinierit të digës/ njesisë së drejtimit teknik të kërkuara nga legjislacioni në fuqi duke përcaktuar në mënyrë të qartë të gjitha detyrat dhe të drejtat e tyre gjatë procesit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së digës.

FALEMINDERIT